



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 936/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.936/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Prishtinë në të cilën theksojnë se në zgjedhjet e mbajtura me datën 17 tetor 2021 pas numërimit të votave është vërejtur se votat e kandidatëve të AAK-së në Prishtinë gabimisht janë shënuar në Formularin e Rezultateve të kandidatëve (FRK) të AAK-së për Kuvendin Komunal në Prishtinë, andaj sipas parashtruesit të apelit është e domosdoshme që te rinumërohen vetëm fletëvotimet për kandidatët e AAK-se për Kuvendin Komunal te Prishtinës me qëllim të eliminimit të këtyre gabimeve teknike si dhe me qëllim të ruajtjes së integritetit të zgjedhjeve dhe besueshmërisë së rezultateve. Parashtruesi i apelit thekson se gjatë plotësimit të FRK-ve komisionerët pa qëllim kanë bërë gabime teknike duke ngatërruar votat ndërmjet kandidatëve të AAK-së. Andaj të njëjtit kërkojnë që te rinumërohen fletëvotimet për kandidatet e AAK-se për Kuvendin Komunal të Komunës se Prishtine, pasi që si pasojë e gabimeve ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me formularët e rezultateve të kandidateve dhe formularit përfundimtar të rezultatit për kandidatët e AAK-se për Kuvendin Komunal të Prishtinës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## **Apeli është i pabazuar**


Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega Prishtinë, me të cilën kërkon rinumërim të votave është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk ka mund që të vërtetohet se kanë ndodhur gabime gjatë shënimit të votave për kandidatët e subjektit politik AAK..

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.936/2021 më datën 06.11.2021



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.